



REPubLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET SKËNDAJ
ADRESA Rr."Reshit ÇOLLAKU",
Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane.
TEL: 0672027200



VËRTETIM NËN SHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 1315

Tirane më 04/03/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2022053980094238295

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ALKET SKËNDAJ**



**DATE 04/03/2022
NR REP 1315**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04.03.2022, para meje Noter ALKET SKËNDAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr."Reshit ÇOLLAKU", Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane., u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Merita Sheqi, atësia Gëzim, amësia Ganimete, shtetase Shqiptare, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Dervish Hima; Nd. 1; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 30/01/1965, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034059814 dhe nr. personal G55130131C , .

DEKLARUES/IT:

Nexhat Sheqi, atësia Brahim, amësia Shuke, shtetas Shqiptar, lindur në Zogaj, Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Dervish Hima; Nd. 1; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 27/05/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034059882 dhe nr. personal F80527110P , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "REJSI FARMACI CHAIN" SHPK date 04.03.2022", bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ALKET SKËNDAJ



AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“rejsi farmaci chain” Sh.p.k



AKT THEMELIMI

dhe

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“rejsi farmaci chain” Sh.p.k

Sot më 04/03/2022 (dymijë e njëzetë e dy), personat si më poshtë:

1. **“SIREJ” sh.p.k**, person juridik, themeluar dhe organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 18/02/2022, me NUIS M21418006F, me seli në Autostradën Tiranë - Durrës, Km. 8, pranë nënkalimit të Autostradës, Vorë, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar sipas Vendimit Nr. 1, datë 03/03/2022 të Asamblesë së Përgjithshme nga Z. Nexhat Sheqi dhe Znj. Merita Sheqi,

në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, ka rënë dakort dhe vendos të themelojnë një shoqëri tregtare dhe të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet dhe kushtet e më poshtme:

KREU I TË DHËNAT E SHOQËRISË

Neni 1 Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare ka emërtimin “rejsi farmaci chain” sh.p.k.

Neni 2 Forma Juridike

- 2.1 Shoqëria ka statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.

Neni 3 Selia

- 3.1 Shoqëria e ka seline e saj në adresën: Rruga e Elbasanit, Pll. Edil-AI-2, Kati 1, Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Me miratim të organeve të saj kompetente shoqëria mund të ndryshojë selinë. Ajo mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe vende të tjera të ushtrimit të veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

Neni 4 Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.



Neni 5 Objekti

- 5.1 Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj: Tregti me shumicë dhe pakicë i barnave e mallrave farmaceutike, mallrave kozmetike dhe të kujdesit të shëndetit. Tregtimi i pajisjeve shëndetësore, shtesave ushqimore e dietetike, etj. Tregtimi i tyre në farmaci dhe çdo aktivitet ndihmës që i shërben aktivitetit të farmacive.
- 5.2 Shoqëria mund të zgjerojë dhe/ose të pakësojë rast pas rasti objektin e veprimtarisë së vet me vendim të organeve të saj kompetente.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali

- 6.1 Kapitali themeltar total i nënshkruar i shoqërisë është 500'000 (pesëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë e vetme, me vlerë nominale prej 500'000 (pesëqind mijë) lekë, e barabartë me kontributet e ortakut të vetëm në shoqëri, që përfaqëson 100% të kapitalit dhe jep të drejta vote proporcionale.
- 6.2 Kapitali është tërësisht në para dhe është nënshkruar dhe do të shlyhet nga ortaku si më poshtë:

Emri	Kuotat (Pjesë)	Vlera Nominale e Kuotës (Lekë)	Shuma e Kontributit (Lekë)	Përqindja e Kapitalit & Të Drejtat e Votave (%)
“SIREJ” SHPK	1	500'000.00	500'000.00	100
TOTAL	1	500'000.00	500'000.00	100

- 6.3 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

Neni 7 Kuotat

- 7.1 Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.
- 7.2 Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë, këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidarë për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.
- 7.3 Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.
- 7.4 Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

Neni 8 Mënyrat e Fitimit dhe Kalimit të Kuotave

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;

- ç) dhurimit;
d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Kur shoqëria përbëhet nga më shumë se një ortak, ortakët mund të transferojnë lirisht kuotat ndërmjet tyre pa nevojën e ndonjë miratimi paraprak. Kurse, për transferimin e kuotave tek palë të treta kërkohet të shterohet e drejta e parablerjes nëpërmjet një njoftimi me shkrim të ofertës nga ortaku propozues tek ortaku tjetër pritës, e vlefshme deri në 15 ditë kalendarike për dërgimin e përgjigjes nga ortaku pritës. Nëse pas 15 ditëve kalendarike ortaku pritës nuk e pranon me shkrim ofertën ose nuk i kthen fare përgjigje me shkrim asaj, atëherë ortaku propozues mund të kaloj lirisht kuotat tek personat e tretë. E drjeta e parablerjes nuk zbatohet për rastin e kalimit të kuotave sipas mënyrës së parashikuar në nenin 8.1/c më sipër.
- 8.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.

KREU III ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9

- 9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
(i) Asambleja e Përgjithshme;
(ii) Administratori/ët;
- 9.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

TITULLI I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10 Kompetencat

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të më poshtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesit/ve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të këtij neni;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
 - m) miraton ndarjen e fitimeve dhe dividendëve;
 - n) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 11 Mbledhja e Asamblesë

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara

në nenin 82 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".
Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

- 11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët e shoqërisë.
11.3 Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend dhe mënyrë tjetër që shihet e përshtatshme nga ortaku/ët.

Neni 12

Thirrja dhe Pjesëmarrja në Asamble

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me postë elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, mënyrën e mbledhjes kur është e ndryshme nga mbledhja fizike, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe ju dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 12.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 12.3 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje personalisht ose të përfaqësuar sipas parshikimeve ligjore.
- 12.4 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje fizikisht ose jo fizikisht nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet elektronike, që mundësojnë identifikimin e tyre, të tilla por pa u kufizuar si:
- a) transmetimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në kohë reale, si video konferencë, etj;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një vendndodhje tjetër, si konferencë telefonike, etj;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje, si projekt vendim qarkullues në formë elektronike, postare apo dorazi, ku secili prej ortakëve jep miratimin e tij me shkresë duke nënshkruar vendimin përkatës (vendim qarkullues), etj.
- 12.5 Për efekt të këtij neni, konsiderohen mjete dhe burime të sigurta identifikimi për të kryer njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme si dhe për të garantuar pjesëmarrjen jo fizike të ortakëve në mbledhje:
- (i) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonit të dorëzuara në formë shkresore (përfshirë e-mail, sms, aplikacione) nga ortakët tek Administratori/ët i shoqërisë, ortakë të tjerë të shoqërisë, ose punonjës të autorizuar të shoqërisë; dhe/ose
 - (ii) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonike të përdorura nga ortakët, me të cilat ato kanë mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me Administratorin/ët, ortakët e tjerë, apo anëtarë/punonjës të tjerë të shoqërisë dhe që njihen gjerësisht se i përkasin atij; dhe/ose
 - (iii) sitemet teknologjike të lidhjes audio dhe video që disponon shoqëria.

Neni 13

Kuorumi dhe Vendimmarrja

- 13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike sipas parshikimeve të këtij Statuti.
- Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 13.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e

kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë dhe për raste të tjera që sipas këtij Statuti kërkohet shumicë e cilësuar. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 10 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

- 13.3 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën, orën e vendin dhe/ose mënyren e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverballi nënshkruhet nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Procesverballi i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët është/janë përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve.
- 13.4 Mbledhja e Asamblesë kryesohet nga një prej anëtarëve të saj të caktuar rast pas rasti nga Asambleja.

TITULLI II ORGANI ADMINISTRATIV


Neni 14

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme mund të emëroj rast pas rasti një ose më shumë Administrator të shoqërisë.
- 14.2 Administratorë të parë të shoqërisë me mandat 5 vjeçar caktohen:
- 1) **Nexhat Sheqi**, i biri i Brahim-it dhe i Suke-s, lindur më 27/05/1958, në Zogaj, Shqipëri, banues në Bulevardin "Bajram Curri", Pll. ETC, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, mbajtës i Letër Njofitimit Nr. 034059882; dhe
 - 2) **Merita Sheqi**, e bija e Gëzim-it dhe e Ganimet-es, lindur më 30/01/1965, në Shkodër, Shqipëri, banues në Bulevardin "Bajram Curri", Pll. ETC, Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare, mbajtëse e Pasaportës Nr. BC2588837.

Neni 15 Kompetencat

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme emëron dhe shkarkon Administratorin/ët e shoqërisë, në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj arsye, me shumicë të zakonshme. Administratori/ët mundet gjithashtu të jap dorëheqjen sipas parashikimeve të ligjit.
- 15.2 Afati i emërimit të Administratorit/ëve është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.
- 15.3 Administratori/ët ka/në këto kompetenca:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) të raportoj përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe këtë Statut.

Administratori/ët është kompetent edhe për të:

- 
- (i) realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
 - (ii) propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë, hapjen, përcaktimin, zhvillimin e departamenteve të shoqërisë dhe të vendeve të tjera të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë;
 - (iii) marrë dhe shkarkojë nga puna personelin dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me të gjithë punonjësit.
 - (iv) propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme në interes të shoqërisë.

KREU IV PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 16

- 16.1 Shoqëria priset në rastet e më poshtme:
 - a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - b) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga ligj;
 - d) në raste të tjera të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera të parashikuara me ligj;
 - f) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.
- 16.2 Me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague. Gjatë fazës së likuidimit emrit të shoqërisë i shtohet pjesa “Në likuidim” që shënohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjatë kësaj periudhe.
- 16.3 Likujduesi i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, kërkon çregjistrimn e shoqërisë pranë QKB, pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura të shoqërisë.

KREU V VITI FINANCIAR

Neni 17

- 17.1 Në përputhje me ligjin shoqëria do të ketë një regjistër në të cilën mbahen bilance vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

Neni 18

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 Janar të çdo viti kalendarik dhe përfundon në 31 Dhjetor të po këtij viti, me përjashtim të vitit të regjistrimit ku viti financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU VI DIVIDENTËT

Neni 19

- 19.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave dhe mbajtjes së rezervës ligjore, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividend, në përpjestim me kuotën që zotëron çdo ortak.

KREU VII
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE


Neni 20


- 20.1 Shoqëria ka vulën e vet në të cilën shkruhet emri i shoqërisë siç e prashikon ligji.
20.2 Për ato që nuk janë parashikuar në këtë Statut zbatohen dispozitat e ligjit.
20.3 Statuti është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën fuqi ligjore.

Përfaqësuesit e ortakut të vetëm të shoqërisë, pasi e lexuan këtë Statut, deklarojnë se e kanë kuptuar përmbajtjen e saj dhe janë dakort me kushtet e saj, prandaj e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë si më poshtë vijon, si shprehje e qëllimit dhe miratimit të tyre.

ORTAKU THEMELUES

“SIREJ” SHPK


Nexhat Sheqi,
Administrator


Merita Sheqi,
Administrator

